



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:072238

Datë: 25.10.2019

Numri i dokumentit: 00604724

P.nr.297/19

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, ne lenden penale PP.II.nr.7-1/19 të datës 30.01.2019, ndaj të pandehurit V. Ll. nga fsh.V. komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.2. i Kodit Penal në prezencë të prokurorit te PTH-së nga Prizreni Atnor Skoro dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor te mbajtur me dt.23.10.2019 mori publikisht dhe shpalli me date 25.10.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari V. Ll. i lindur më 05.04.1976 i biri i M. Ll. dhe nënës Z., e gjinisë H. , me vendbanim në fsh. V. Komuna Suhareke, ka te kryer 4 klase te shkollës fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës, me numër personal

ESHTE FAJTOR

Sepse me dt. 05.01.2019, rreth orës 21.40 minuta, ne fshatin V. Komuna Suharekë, saktësisht ne shtëpinë e përbashkët familjare i shkakton lëndime te lehta trupore vëllait te tij – te dëmtuarit I. Ll., ne atë mënyrë qe pas një mosmarrëveshje paraprake, qe fillimisht kishte me babain e tij M. Ll. te cilin e ofendon dhe shanë, ku me par ndërhyrë i dëmtuari – I. Ll. me qellim qe te qetësoj situatën duke ndërmjetësuar me shtyrë me qe rast i pandehuri – V. Ll. e sulmon fizikisht duke e goditur ne pjesën e kokës me një sopat, mjet ky i rrezikshme me te cilin mund ti shkaktonte ndonjë lëndim te rende trupor, me te cilat veprime teki dëmtuari ka shkakuar lëndime te lehta trupore te konstatuara nga akt ekspertimi mjeko-ligjor, i çështjes si ndrydhje ne indet e buta te anës se majte (jo i mpreht) dhe si te tilla bëjnë pjese ne lëndime te lehta trupore nga dt. M. G., te dt. 13.01.2019.

Me këtë ka kryer veprën penale lëndimi i lehte trupor, nga neni 188 par. 3 pika 3.2 i Kodit Penal.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 45, 73, 74 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 te KP-së, i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Duke i vërtetuar dënim me burgim prej 5 (pese) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse ne afatin e verifikimit prej nje viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të ekspertizës mjeko-ligjore ta paguaj shumën prej 20 euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumen prej 30 euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

I dëmtuari: I. M. Ll. nga fsh. V. Komuna Suhareke, udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike, ta realizojë në kontest të rregullt civil

A r s y e t i m

PTH. nga Prizreni me aktakuzën **PP.nr. PP.II.nr.7-1/19** të datës 30.01.2019, ndaj të pandehurit V. Ll. nga fsh. V. komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.2 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjate shqyrtimit gjyqësor e ka përfaqësuar PTH në Prizren Atnor Skoro, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm duke vepruar edhe sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, dhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP, në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj Gjykata ka vendosur se i akuzuari është fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, është penduar për veprën penale të kryer, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

G j y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.